



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 40 (827687)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 9 Tetor 2020

## Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



### Dekretohen komandantët e Forcës Tokësore dhe Forcës Detare

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, sh.t.z. Ilir Meta, ka dekretuar me Nr. i Dekreti 11573, datë 2 Tetor 2020 emërimin e gjeneral brigade Arben Kingji komandant të Forcës Tokësore dhe me Nr. i Dekreti 11574, datë 2 tetor 2020, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia komandant të Forcës Detare. Në dekretet, përkatëse thuhet

se: "Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 169, pika 3, të Kushtetutës, të nenit 9, pika 3, germa "c", e ligjit nr.64/2014,"Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimin e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes...

» faqe 2

## Batalioni i Këmbësorisë

### Zhvillohet stërvitja e koduar "Porta e hekurt 20"



» faqe 4

## Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka-Ministri i Punëve të Brendshme Agim Veliu

# Do të përdoren edhe avionë në përballimin e fatkeqësive natyrore

Firmoset marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunim e ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera » faqe 3



## ANO

### Kursi 45-të Bazë i Nënoficerit po ndiqet nga 61 kursantë

Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (ANO), vijon të zhvillojë me intensitet programin e saj mësimor, nën masa rigorozë sigurie dhe distancimi fizik, të imponuara prej pandemisë COVID-19. Trupa mësimore e QAPN-së (ANO-së) është e angazhuar maksimalisht në realizimin e kurseve...



» faqe 2

## Rekord Kombëtar

### Ushtarakja Luiza Gega triumfon në Maratonën e Shkupit

Luiza Gega triumfoi në Maratonën e 16-të të Shkupit. Në këtë garë atletja shqiptare ka thyer edhe rekordin kombëtar me më shumë se 23 minuta. Më i miri në garën prej 42 kilometra ishte ukrainasi Serhi Shevçenko, ndërsa në kategorinë e femrave shqiptarja Luiza Gega. 1500 pjesëmarrësit tjerë kryesisht u argëtuan me shpresën se deri në garën e radhës...

» faqe 3

### Konflikti në Mesdheun Lindor

## NATO vendos Mekanizmin Ushtarak të de-konfliktit midis Greqisë dhe Turqisë

» faqe 8

### GJENERALBRIGADE MANUSHAQE SHEHU

## Femrat ushtarake përbëjnë rreth 14 % të personelit ushtarak të FA

» faqe 4

### VITI AKADEMIK 2021 DERI 2025

## Fillon aplikimi: 18 bursa studimi në tre akademi ushtarake në SHBA

» faqe 5





PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ILIR META

# Dekretohen komandantët e Forcës Tokësore dhe Forcës Detare

*Gjeneral brigade Arben Kingji komandant i Forcës Tokësore dhe gjeneral brigade Ilir Xhebexhia komandant i Forcës Detare*

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, sh.t.z. Ilir Meta, ka dekretuar me Nr. i Dekreti 11573, datë 2 Tetor 2020 emërimin e gjeneral brigade Arben Kingji komandant të Forcës Tokësore dhe me Nr. i Dekreti 11574, datë 2 tetor 2020, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia komandant të Forcës Detare.

Në dekretet, përkatëse thuhet se:

“Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 169, pika 3, të Kushtetutës, të nenit 9, pika 3, germa “c”, e ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes me nr. prot. 4264/1, datë 01.10.2020, Dekretoj, Gjeneral brigade Arben Voke Kingji, me detyrë Komandant i Batalionit të Mbështetjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, emërohet “Komandant” i Forcës Tokësore.

“Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 169, pika 3, të Kushtetutës, të nenit 9, pika 3, germa “c”, e ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes me nr. prot. 4264/1, datë 01.10.2020, Dekretoj, Gjeneral brigade Ilir Hasan Xhebexhia, me detyrë Zëvendëspërfaqësues Ushtarak në NATO, Atashe Ushtarak i RSH në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë, në Përfaqësinë Ushtarake Jashtë Vendit, në Ministrinë e Mbrojtjes, emërohet “Komandant” i Forcës Detare”.

\*\*\*

Ushtarakut Arben Kingji, ju akordua grada madhore Gjeneral brigade nga Presidenti i Republikës, me dekret Nr. 11703, më 11.09.2020. Kolonel Arben Kingji mban aktualisht detyrën e komandantit të Batalionit të Mbështetjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Gjeneral brigade Arben Kingji ka ushtuar edhe detyra të tjera si ajo e atasheut ushtarak të Republikës së Shqipërisë në Rumani. Me herët ai ka qenë edhe komandant i Policisë ushtarake. Ka kryer Kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë. Gjeneral brigade Kingji ka mbajtur detyrën e komandantit të kontingjentit në disa misione në Afganistan e Irak.

Në vitin 2016 ai përfundoi edhe studimet për drejtësi në Winsdom University. Për kontributet e tij në Forcat e Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji është nderuar me disa medalje. Ai mban edhe medaljen e Artë të Shqiponjës, dhënë nga Presidenti i Republikës.

Kolonel Ilir Xhebexhia aktualisht mban detyrën e zëvendëspërfaqësuesit ushtarak në NATO, atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë, në Përfaqësinë Ushtarake Jashtë Vendit.



Ai ka përfunduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes. Ndërsa në 2006-2007 ka qenë oficer koordinator, pranë Komandës Qendrore Amerikane Tampa-Florida USA. Ai ka ushtuar edhe detyra si zëvendëskomandant i Qendrës së Radio-Zbulimit, nënkolonel, oficer Shtabi për Inteligjencën, Përfaqësia Ushtarake - Bruksel.

Ai ka marrë pjesë në disa misione ndërkombëtare si: stërvitja “Rescuer”, Maqedoni; oficer koordinator “Rescuer”, Maqedoni; misioni i SFOR-it në Bosnje-Hercegovine; operacioni “Liria Irakut” (C-2 në CJTF-7) në Bagdad.

Në formimin e tij, tashmë gjeneral brigade Ilir Xhebexhia numëron edhe

një sërë kursesh në Turqi, Gjermani, Greqi, Holandë. Gjatë karrierës së tij, gjeneral brigade Xhebexhia është vlerësuar me disa dekorata, përfshirë; “Medalja e NATO-s për Misionin e Paqeruajtjes” 1998, dhënë nga sekretari i Përgjithshëm i NATO. Ai botoi dy libra, “Liria e Irakut” në 2006 dhe “Evropa Juglindore Proceset Integruese” në 2007 dhe bashkëautor në disa botime të tjera.

\*\*\*

Ushtarakut Ilir Xhebexhia, ju akordua grada madhore gjeneral brigade me dekret të Presidentit të Republikës, Nr. 11704, më 11.09.2020.



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia aktualisht mban detyrën e zëvendëspërfaqësuesit ushtarak në NATO, atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë, në Përfaqësinë Ushtarake Jashtë Vendit. Ai ka përfunduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes. Ndërsa në 2006-2007 ka qenë oficer koordinator, pranë Komandës Qendrore Amerikane Tampa-Florida USA. Ai ka ushtuar edhe detyra si zëvendëskomandant i Qendrës së Radio-Zbulimit, nënkolonel, oficer Shtabi për Inteligjencën, Përfaqësia Ushtarake-Bruksel.

Ai ka marrë pjesë në disa misione ndërkombëtare si: stërvitja

“Rescuer”, Maqedoni; oficer koordinator “Rescuer”, Maqedoni; misioni i SFOR-it në Bosnje-Hercegovine; operacioni “Liria Irakut” (C-2 në CJTF-7) në Bagdad.

Në formimin e tij, tashmë gjeneral brigade Ilir Xhebexhia numëron edhe një sërë kursesh në Turqi, Gjermani, Greqi, Holandë. Gjatë karrierës së tij, gjeneral brigade Xhebexhia është vlerësuar me disa dekorata, përfshirë; “Medalja e NATO-s për Misionin e Paqeruajtjes” 1998, dhënë nga sekretari i Përgjithshëm i NATO. Ai botoi dy libra, “Liria e Irakut” në 2006 dhe “Evropa Juglindore Proceset Integruese” në 2007 dhe bashkëautor në disa botime të tjera.

## QENDRA E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE (ANO)

### Kursi 45-të Bazë i Nënoficerit po ndiqet nga 61 kursantë

*Kursantët e Kursit Bazë do të ndjekin programin mësimor për 8 javë me radhë*

Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve (ANO), vijon të zhvillojë me intensitet programin e saj mësimor, nën masa rigorozë sigurie dhe distancimi fizik, të imponuara prej pandemisë COVID-19. Trupa mësimore e QAPN-së (ANO-së) është e angazhuar maksimalisht në realizimin e kurseve të planëzuara vjetore. Me 10 shtator nisen mësimin kursantët e përzgjedhur për ndjekjen e Kursit 45-të Bazë të Nënoficerit në ANO. Ata po marrin njohuritë bazë të punës së nënoficerit me gradën Tetar.

Kursantët e Kursit Bazë do të ndjekin programin mësimor për 8 javë me radhë. Gjatë këtij harku kohor programi mësimor i kursit do të ketë një ndërthurje të njohurive teorike dhe praktike, ku fokusi do të jetë marrja e njohurive bazë dhe të përgjithshme për përgatitjen e drejtuesve në rol të komandantit të skuadrës në radhët e Forcave të Armatosura, njohuri të cilat kursantët i thellojnë më tutje pikërisht në specialitetin përkatës. Të përzgjedhurit për të ndjekur këtë kurs janë 61 kursantë.



STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”



## Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka-Ministri i Punëve të Brendshme Agim Veliu

## Do të përdoren edhe avionë në përballimin e fatkeqësive natyrore

*Firmoset marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunim e ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera*



Në takimin e dy qeverive, të Shqipërisë dhe Kosovës, zhvilluar më 2 tetor 2020, në Tiranë, midis 14 marrëveshjeve, ishte edhe nënshkrimi i Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Ne praninë e kryeministrave Rama dhe Hoti, marrëveshja u firmos nga Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Agim Veliu. Marrëveshja në fjalë, do t'i përcaktoj format e bashkëpunimit, procedurat për dhënien e ndihmës, procedurat e kalimit kufitar dhe rregullat për qëndrimin e ekipeve të shpëtimit, kalimin kufitar të pajisjeve dhe artikujve të ndihmës, strehimit dhe ndihma e të zhvendosurve, përdorimin e Avionëve si dhe bashkërendimin dhe menaxhimin e operacioneve të ndihmës ndaj fatkeqësisë, etj.

Ministrja e mbrojtjes Olta Xhaçka tha se "Marrëveshja që firmosim sot mes dy Ministrave të Mbrojtjes për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera vjen si produkt i dëshirës sonë të dyanshme dhe i përputhjes së objektivit të dy qeverive, për të forcuar bashkëpunimin për Mbrojtjen Civile, por mbi të gjitha është një marrëveshje, e cila do t' i bëjë qytetarët shqiptarë në të dy anët e kufirit më të sigurt përballë rreziqeve dhe kërcënimeve nga emergjencat, të cilat siç jemi dëshmitarë të gjithë janë kthyer në një sfidë të vërtetë gjatë viteve të fundit.

Unë besoj që bashkëpunimi dhe krijimi i sinergjive mes Shqipërisë e Kosovës është i natyrshëm dhe i dëshiruar në çdo fushë e sektor, por Emergjencat Civile, janë padyshim një fushë ku ky bashkëpunim është më i natyrshëm dhe më i lehtë për t'u realizuar se kudo tjetër. Kjo jo thjesht për shkak të interesit të përbashkët dhe

përfitimeve të dukshme që kemi duke bashkuar forcat, apo të faktit që sfidat me të cilat përballlemi për sa i përket menaxhimit të fatkeqësive natyrore, apo atyre të shkaktuara nga dora e njeriut, janë shumë të ngjashme, por mbi të gjitha sepse është një bashkëpunim që ngrihet mbi një traditë të konsoliduar e fisnike mes shqiptarëve këtej e andej kufirit për të ndihmuar njëri - tjetrin në raste vështirësish e rreziqesh. Tërmeti

i 26 Nëntorit ishte veç shembulli më i fundit i kësaj tradite, kur Kosova ishte e para që nxitoi të na ndihmonte në momentin tonë të tragjedisë duke dërguar ekipe shpëtimit që në orët e para të asaj nate. Unë jam shumë optimiste që ne do të dimë të bashkëpunojmë në mënyrë efikase në përputhje me këtë marrëveshje që skicon kuadrin e përgjithshëm të bashkëpunimit në fushën e përballimit të emergjencave,

duke filluar me planifikimin e masave parandaluese, ofrimin e ndihmës së ndërsjellë në kërkim-shpëtim dhe eliminimin e pasojave, apo në bashkëpunimin për rritjen e kapaciteteve logjistike, njerëzore e institucionale të strukturave të Mbrojtjes Civile.

Më konkretisht, do të bashkëpunojmë ngushtë në dhënien e ndihmës, shkëmbimin e informacionit apo ekspertizës, përgatitjen e programeve

të përbashkëta, kërkimin shkencor, furnizimin e pajisjen e ekipeve në terren, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, në planifikimin e përbashkët, e kështu me radhë.

Shqipëria ka filluar tashmë një proces realisht ambicioz modernizimi e transformimi të Emergjencave Civile, duke kaluar një ligj të hartuar me mbështetjen e partnerëve. Kemi hedhur hapa të mëdha drejt modernizimit jo vetëm të strukturave, përmes ngritjes së Agjencisë së Mbrojtjes Civile, por edhe të bazës materiale, pajisjeve, mjeteve. Por mbi të gjitha kemi bërë shumë progres në transformimin e qasjes ndaj rreziqeve natyrore duke e kaluar fokusin nga reagimi tek parandalimi.

Situata e shkaktuar nga tërmetet e vitit që shkoi, nga zjarret e shumta që kemi përjetuar gjatë këtij viti, e padyshim edhe nga pandemia na ka detyruar t'i përshpejtojmë planet e afatet, duke ia dalë që në vetëm një vit të arrijmë një nivel gatishmërie e operativiteti, që në planet fillestare do të kishte kërkuar së paku 4 apo 5 vjet, por sigurisht kemi shumë rrugë për të bërë akoma derisa struktura për të cilën po punojmë të jetë e standardeve që kërkohen për t'u anëtarësuar në Mekanizmin e BE për Mbrojtjen Civile".

## REKORD KOMBËTAR

## Ushtarakja Luiza Gega triumfon në Maratonën e Shkupit

Luiza Gega triumfoi në Maratonën e 16-të e Shkupit. Në këtë garë atletja shqiptare ka thyer edhe rekordin kombëtar me më shumë se 23 minuta. Më i miri në garën prej 42 kilometra ishte ukrainasi Serhi Shevçenko, ndërsa në kategorinë e femrave shqiptarja Luiza Gega. 1500 pjesëmarrësit tjerë kryesisht u argëtuan me shpresën se deri në garën e radhës kriza korona do të kalojë.

Maratona e Shkupit u mbajt në 4 tetor nën një protokoll të veçantë për mbrojtje nga COVID-19 dhe nën moton "Vrapimi do t'ju ndryshojë".

Sportistët e të gjitha moshave morën pjesë në çdonjërin prej katër garave në maratonën e 16-të në Shkup "Vizer", prej të cilave më të vështira janë ato prej 21 dhe 42 kilometra.

Atletja Luiza Gega tha për se maratona edhe pse nuk është lloji i garës së saj, ishte një test shumë i mirë për të matur gjendjen e saj



fizike në kushtet e mungesës së aktiviteteve për shkak të pandemisë.

Ajo ndau shqetësimin se pamundësisë për t'u stërvitur në stadiumin e Elbasanit, që është një stadium me pistë vrapimi, pasi siç

tha prej dy muajsh është marrë vendimi që të mos lejohet. "Nuk jam penguar në asnjë vend të botës për t'u stërvitur si një artiste që mundohet ta pranojë vendin e saj denjësisht", tha Luiza Gega.



## Specialistët e EOD shëmbin pallatin 12-katësh

Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios në Komandën Mbështetëse së bashkëpunim me Inspektoriatin Kombëtar të Mjedisit dhe Territorit (IKMT) bënë të mundur shkatërrimin e pallatit 12-katësh në Lagjen nr. 17 të Bashkisë Durrës, të dëmtuar në nëntorin e vitit të kaluar. Ky është konsideruar një nga operacionet më të vështira deri më tani, pasi u desh një punë voluminoze për hapjen e mbi 3000 furnelave nga ekspertët e Batalionit të Xhenios.

Kjo punë ka filluar që në muajin korrik 2020 dhe u finalizua mbasditen e të shtunës që kaloi. Për realizimin e këtij operacioni u përdor një sasi e konsiderueshme lënde plasëse, tre mjete transporti, një agregat dhe 39 specialistë të Batalionit të Xhenios. Gjatë operacionit nuk pati problem.



## BATALIONI I KËMBËSORISË

## Zhvillohet stërvitja e koduar "Porta e hekurt 20"

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte kompaktësimi i veprimeve të kompanisë së këmbësorisë në mbrojtje

Nga data 28-30 shtator, Batalioni I Këmbësorisë zhvilloj stërvitjen kompaktësuese 72-orëshe të koduar "Porta e hekurt 20". Qëllimi i kësaj stërvitje ishte kompaktësimi i veprimeve të kompanisë së këmbësorisë në mbrojtje.

Stërvitja realizoj me sukses objektivat e saj si: rritja e nivelit të planizimit dhe zhvillimit të stërvitjes, përmirësimi i gatishmërisë së nën reparteve dhe aftësisë drejtuese në re-

alizimin e operacioneve të mbrojtjes. Planizimi dhe realizimi i stërvitjes u krye me skenar real luftimi gjatë gjithë fazave të operacionit mbrojtës.

Përfundimi me sukses i stërvitjes vjen si rezultat i angazhimit nëpërmjet profesionalizmit dhe disiplinës së treguar nga të gjithë efektivat pjesëmarrëse, si dhe nën monitorimin e veçantë të komandantit të batalionit nënkolonel Ali Mali.



## ZV/SHEFE E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FA, GJENERALBRIGADE MANUSHAQE SHEHU

# Femrat ushtarake përbëjnë rreth 14 % të personelit ushtarak të FA

Promovohet libri "Gratë oficere në rrjedhën e historisë" dhe dokumentari "Ato janë të parat"

Në kuadrin e 50 vjetorit të Kursit të Parë të Oficereve shqiptare, Shoqata Kombëtare e Ush-tarakëve në Rezervë të Shqipërisë në Bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës në datën 4 tetor 2020, organizoi një aktivitet pranë Muzeut Historik Kombëtar për promovimin e librit "Gratë oficere në rrjedhën e historisë" dhe filmit dokumentar "Ato janë të parat". Në këtë aktivitet mori pjesë edhe zv/shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralebrigade Manushaqe Shehu e cila mbajti fjalën: "Mbi vlerat e librit në dokumentimin e gruas shqiptare në historinë e Forcave të Armatosura".

Gjeneralebrigade Manushaqe Shehu, në këtë promovim, tha se: "Sot femrën ushtarake, ashtu si edhe dje e gjen kudo, në stërvitje në trajnim në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe të Akademive Ushtarake jashtë vendit. Atë e gjen ushtarake profesioniste në fushat dhe poligonet e stërvitjes, nënofficere dhe oficere gati në gjithë Shqipërinë, kudo ku ka reparte ushtarake. Atë e gjen në misionet paqeruajtëse në Afganistan, në Letoni, në Sudanin e Jugut, në Përfaqësitë Ushtarake në Bruksel, në shtabet e NATO-s, por e gjen edhe si politikane në parlamentin shqiptar. Atë e gjen prefekte, atashe ushtarake, komandante të strukturave të ndryshme, atë e gjen në të gjitha gradat, përfshi edhe ato të larta e madhore, kolonele e gjenerale.

E ku nuk e gjen sot femrën ushtarake shqiptare, si ato që vijojnë karrierën ushtarake ashtu edhe ato që kanë dalë në rezervë dhe janë aktive në jetën shoqërore të vendit. Kudo është dora, mendja dhe fuqia e saj mendore e fizike.

Miratimi dhe zbatimi i "Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore", në mbështetje të rezolutës 1325 "Gruaja, Paqja dhe Siguria", miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, ka bërë që femra ushtarake aktive sot të përbëjnë rreth 14 % të personelit ushtarak të FA, me synimin për të arritur shifrën prej 15 %. Po ashtu miratimi i para disa muajve të dokumentit "Politikat dhe procedurat e mbrojtjes kundër ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale në punë", tregon kujdesin e vazhdueshëm të Ministrisë të Mbrojtjes, znj. Olta Xhaka, ndaj femrave dhe në veçanti ndaj femrës ushtarake.

Unë jam një kolegia juaj e brezit të viteve 1984-1988. Secila nga ju ka se çfarë të kujtojë nga jeta ushtarake. Secila nga ju ka patur një idhull në jetë. E kush nga ne nuk dëshironte t'i ngjante komandantes Sheqere Mema, një oficere e spikatur e Forcave të Armatosura. E kush prej nesh nuk dëshironte të ishte si oficere Ilirjana Sulkuqi, një drejtuese e aftë, një motër dhe nënë për ne në atë kohë, por mbi të gjitha edhe një krijuese me talent të rrallë. Apo Lida Grazhdanit, e cila aq bukur e ka përshkruar jetën e femrës shqiptare në librin "Pesha dhe bukuria e uniformës",



Liljana Meros e kudo gjendur dhe sot aktiviste e shquar e Shoqatës së Ush-tarakëve në Rezervë.

Por sot me siguri femrat ushtarake aktive kërkohet të jenë si: kolonele Vehbie Kutli, aktualisht në shtabin e KFOR-it në Kosovë, nënkolonele Elsa Prasta në Përfaqësinë Ushtarake në Bruksel, nënkolonele Arta Driza, kampione dhe gjyqtare ndërkombëtare e sportit të shahut, kapiten Viola Hoxha dhe majore Valentina Korbi që sapo përfunduan misionin paqeruajtës prej një viti në Sudanin e Jugut, kapiteneve Elinora Metolli dhe Rudina Pina, që sapo kanë shkuar në mision, e plotë të tjera femra, të cilat kanë sakrifikuar çdo gjë për Forcat e Armatosura.

Sakrificat e femrës ushtarake shkojnë edhe me dhënien e jetës, siç ishte rasti i aktit sublim të "Dëshmores të Atdeut", nëntetares Zarife Hasanaj. E shembuj të tillë patjetër që ka secila nga ju. Por le t'i kthehemi qëllimit për të cilën dy autorët Kujtimi e Zana na kanë mbledhur. Libri "Gratë oficere në rrjedhën e historisë", Volumi i dytë, është një përpjekje e lavdërueshme dhe një kontribut i veçantë i dy autorëve

për të përmbledhur në një botim enciklopedik me vlera për gratë luftëtare dhe komandante në histori, e që shumë prej tyre dhanë jetën në periudha të ndryshme të historisë tonë kombëtare për lirinë, pavarësinë, ndërtimin, zhvillimin e ruajtjen e shtetit të pavarur e modern shqiptar. Ka kaluar mbi gjysmë shekulli në Forcat e Armatosura që vajzat dhe gratë shqiptare kanë nisur studimet në Shkollën e Bashkuar dhe të përpjekjeve shumë vjeçare në ushtri. Këto ishin përfaqësuese të një brezi që ecën në gjurmët e vajzave e grave trimëresha partizane, por edhe më parë që kishin rrëmbyer armët për mbrojtjen e vendit dhe çlirimin e tij. Libri reflekton të gjitha gratë ushtarake që figurojnë si të tilla në të gjithë dokumentacionin e shtetit shqiptar. Ky volum i dytë i librit, është një botim i cili jep një ndihmesë dhe kontribut të madh në njohjen me jetën dhe veprimtarinë e gruas ushtarake në histori. Shpresoj se ky libër do të jetë një ndihmë për të gjitha institucionet shtetërore, për Ministrinë e Mbrojtjes, për kërkuesit e historianët, si dhe të gjithë familjarëve që kanë emrin e grave ushtarake që kanë bërë emër të mirë

në histori dhe pasardhësit e tyre do të krenohen për veprën dhe luftën titanike të bëra nga gjyshet e nënat e tyre.

Praktika e ndjekur për hartimin e këtij libri, puna me materiale dokumentare, arkiva, puna kërkimore, pyetësorët, shtypi ushtarak, si dhe libra me temë nga Forcat e Armatosura, na sjellin një bibliografi të një jetë të gjatë të pionierëve të para ushtarake që me guxim hapën rrugë dhe shtigje të reja për gruan shqiptare. Kjo përvojë ishte një dëshmi e emancipimit të saj, e cila me guxim dhe kurajo, me durim dhe këmbëngulje, me vullnet dhe pasion, bëri që ushtria të mësonte prej tyre. Nëpërmjet faqeve të librit dalin personazhe të grave me uniformë në vite që me punën e tyre dinjitoze e integruan atë në ushtrinë shqiptare, duke bërë të përbashkët pjesëmarrjen e tyre në pozicion të barabartë me burrat. Vajzat dhe gratë shqiptare u arsimuan dhe shërbyen në radhët e Forcave të Armatosura me dinjitet. Libri është reflektim i një pune të gjatë e voluminoze të gruas ushtarake gati me shumë se gjysmë shekullor e cila ka qenë bashkudhëtare në historinë e Forcave të Armatosura duke lënë gjurmë të arta në të gjithë treguesit e gatishmërisë luftarake. Libri na jep të dhëna të reja ku bëhet evidentimi dhe njohja e vlerave të ushtarakes shqiptare, për të cilët deri më sot nuk kemi pasur të dhëna të plota.

Pavarësisht se libri është një renditje dhe klasifikim i emrave të grave ushtarake, por pas secilit emër qëndron një histori e madhe, një jetë aktive në shërbim të atdeut. Janë pikërisht këto vlera të mëdha njerëzore, ato që i japin kuptim historisë, ato që përbëjnë ngjarje të mëdha në jetën e një kombi e shteti, ato që evidentojnë rolin e gruas ushtar-

ake në përcaktimin e zhvillimeve të rëndësishme historike të Forcave të Armatosura. Historia e Shqipërisë, është histori lufte për mbijetesë, e përpjekjeve për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin kombëtar, e sakrificave të mëdha për liri e mëvetësi, ku grua shqiptare dhe ajo luftëtare dhe ushtarake ka luajtur një rol parësor. Libri është historia e gruas ushtarake e këtij kombi. Pas Luftës së Dytë Botërore gratë ishin pjesë e Forcave të Armatosura në shumë vende, ku u bënë dhe prioritete të politikave dhe strategjive shtetërore për barazi gjinore. Shqipëria si vend anëtarë i Aleancës ka një përqindje të ndjeshme të grave me uniformë. Shqipëria dhe Forcat e Armatosura krenohen me përparimet që ka bërë grua shqiptare, ajo sot është më e sigurt, më e përparuar, më pranë familjes së madhe evropiane, e barabartë me gruan ushtarake të aleancës në NATO. Kjo është pjesë e meritës së tyre. Kjo na detyron që të jemi mirënjohës duke i vlerësuar për punën e tyre, duke ndjerë krenari për sakrificat e bëra në rrugëtimin e tyre nën uniformën ushtarake.

Në vijim të programit sot do të kemi rastin të ndjekim edhe filmin dokumentar "Ato janë të parat", kushtuar 50 vjetorit të Kursit të Parë të Oficereve shqiptare. Me këtë rast dua të falënderoj iniciuesit e këtij filmi, Shoqatën Kombëtare të Ush-tarakëve në Rezervë, në mënyrë të veçantë regjisorin e talentuar me shumë eksperiencë e të palodhur, ish ushtarakun Verdi Taken, i cili edhe pse këtë moshë të thyer po na sfidon me memorien dhe freskinë e mendimeve të tij artistike".





## Viti Akademik 2021 deri 2025

# Fillon aplikimi: 18 bursa studimi në tre akademi ushtarake në SHBA

## Akademia West Point amerikane

Qendra e Personel Rekrutimit ka bërë publik, më 1 tetor 2020, në faqen e Web të Ministrisë së Mbrojtjes, praktikën apo kërkesën për aplikim nga e cila do të përzgjidhen 6 (gjashtë) kandidatë për çdo Akademi Ushtarake (Akademinë e Forcave Ajrore, Akademinë e Forcave Detare dhe Akademinë West Point) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra 18 gjithsej, për vitet akademike 2021-2025. Kandidatët e përzgjedhur do të jenë pjesë e seleksionimit të mëtejshëm nga vendi pritës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 6 nëntor 2020.

## Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar. Të mos jetë i dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 23 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik (1 qershor 2021). Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 për femrat. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë nga ana fiziko-shëndetësore nga Njësia Mjekësore Ushtarake, për të shërbyer në FA. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet e vitit të fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para dhe në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave. Të ketë notën mesatare të arsimit parauniversitar, jo më pak se 7 (shtatë). Të mos jetë i martuar. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zëmërës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes). Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohet nga vendi pritës në Shqipëri ose pranë akademive ushtarake jashtë vendit. Të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar e të

*Akademi Ushtarake në SHBA janë: Akademia e Forcave Ajrore, Akademia e Forcave Detare dhe Akademia West Point. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 6 nëntor 2020*



Akademia e Forcave Ajrore amerikane

folur dhe të sigurojnë mbi 75 pikë në testimin ALCPT. Ata duhet të jenë regjistruar për zhvillimin e testeve online të TOEFL dhe SAT ose ACT, me datë testimi jo më vonë se data 5 dhjetor 2020. Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a. Kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit. b. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

## Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pritjes të Qendrës së Personel Rekrutimit, Tiranë do-

kumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim për ndjekjen e studimeve

ushtarake, ku të specifikohet institucioni arsimor dhe preferenca e degës për të



Akademia e Forcave Detare amerikane



cilën aplikohet. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Dokumenti i cili vërteton se aplikanti është regjistruar për testimet që zhvillohen online për TOEFL dhe SAT ose ACT. Certifikatë për TOEFL, SAT ose ACT nëse ka. Raport mjekësor i aftë për të kryerjen e studimeve, të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vend-

banimit të kandidatit, i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorët e certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 10 ditëve:

Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata. Vërtetim nga prokuroria. Vërtetim nga përmbartimi. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML) i Njesisë Mjekësore Ushtarake.

## Datat e testimit:

Do të zhvillohen katër teste në data të caktuara. Data e testimit për gjuhën e huaj (Anglisht) do të jenë 09.11.2020. Data e testimit fizik do të jetë 09.11.2020. Data e testimit intelektual do të jetë 10.11.2020. Kurse data e testimit psikologjik do të jetë 10.11.2020.



## Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, organizimi dhe funksionimi

# Detyrat funksionale të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak


*Vrojtimet meteorologjike në vendmatjet e rrjetit të Sherbimit Meteorologjik Ushtarak, kryhen në përputhje me udhëzuesit teknikë të Organizatës Botërore të Meteorologjisë*

**D**etyra kryesore funksionale e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak janë: asistenca mbi gjendjen reale të motit dhe tendencën e saj për një periudhë disa ditore në mbështetje të plotësisht të detyrave për mbrojtjen e sigurimit kombëtar. Për të realizuar këtë detyrë duhet të: kryejë monitorimin e pandërprere 24 ore, të proceseve e dukurive atmosferike, sipas udhëzuesve të vrojtimit meteorologjik, në vendmatjet meteorologjike në varësi të këtij shërbimi, regjistrimin e të dhenave të vrojtimit dhe perpunimin e tyre në tabelat perkatese, grumbullimin dhe arkivimin e informacionit operativ nga vendmatjet meteorologjike në varësi të këtij shërbimi në qendër (Tiranë), dërgimin e informacionit meteorologjik në arkivën kombëtare meteorologjike pranë Institutit Hidrometeorologjik të Akademisë së Shkencave, kundrejt mareveshjes për percaktimin e detyrimeve të ndërsjella, sigurimin e informacionit meteorologjik në shtresat e sipërme të atmosferës, përpilimin e diagramave termodinamike, përpilimin e buletinit meteorologjik për gjendjen reale të motit dhe parashikimin e tij.

Shefi i Sherbimit Meteorologjik Ushtarak është oficer aktiv dhe varet direkt nga Komandanti i Forcave Ajrore dhe ka për detyrë: të drejtojë dhe kordinojë punën në shërbimin meteorologjik ushtarak. Në bashkëpunim me Institutin Hidrometeorologjik të hartojë programet e kualifikimit të vazhdueshëm të personelit, të kontrollojë zbatimin e programit të kualifikimit të personelit (që nga vrojtues deri në sinoptikan). Ai dhe i ngarkuari i tij brenda juridiksionit, është perfaqësuesi i Sherbimit Meteorologjik Ushtarak në të gjitha nivelet dhe nevojat e perfaqësimit. Vetëm ai dhe personat e autorizuar prej tij, kanë të drejtë të marrin informacion meteorologjik në rrjetin e shërbimit meteorologjik ushtarak.

Shefi i zyrës qendrore varet nga Shefi i Sherbimit Meteorologjik Ushtarak, zevendeson atë dhe ka për detyrë: të organizojë dhe garantojë mbarevajtjen e punës në zyrën qendrore, të marrë pjesë çdo ditë në konsultën e mëngjesit dhe në të gjitha konsultat e tjera të thirrura në varësi të situatës meteorologjike të ndjekur nga sinoptikanti i shërbimit, të drejtojë analizën mujore të punës me personelin e zyrës qendrore, të kordinojë punën për plotësimin e nevojave për informacion të artillerisë kundërajrore dhe zyrës së parashikimit, të kordinojë marrëdhëniet ndërmjet shefave të seksioneve për shkëmbimin e informacionit meteorologjik të mbledhur nga vrojtimet në të gjithë rrjetin.

Shefi i degës pranë aeroportit varet nga shefi i Zyres Qendrore. Ai ka për detyrë: të organizojë dhe drejtojë punën në degën e tij, të bashkëpunojë



me komandën e repartit për planizimin e fluturimeve, të bëjë asistencën meteorologjike gjatë fluturimeve ajrore, në bashkëpunim me IHM të kontrollojë gjendjen dhe funksionimin normal të aparaturave meteorologjike, të përgatitë buletin meteorologjik në ditët e përgatitjes për fluturim dhe të raportojë para efektivit pilot mbi kushtet e motit për ditën e fluturimit, të përgatitë buletin meteorologjik në ditën e fluturimit, të raportojë për kushtet aktuale të motit dhe ecurinë e tyre gjatë periudhës së fluturimit.

Në rastet kur ka fenomene atmosferike të rrezikshme për fluturimin vë në dijeni menjëherë udhëheqesin e fluturimit. Për çdo problem që lidhet me mbarevajtjen e punës, vë në dijeni shefin e Zyres Qendrore dhe shefin

varet nga shefi i Zyres Qendrore. Ai ka për detyrë: të organizojë dhe kontrollojë punën në degë, të informojë shefin e Zyres Qendrore dhe shefin e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak për çdo problem që ka lidhje me mbarevajtjen e punës, të organizojë punën për dënimin e informacionit meteorologjik në Zyrën Qendrore. Në bashkëpunim me IHM të kontrollojë gjendjen dhe funksionimin normal të aparaturave meteorologjike, të ndjeko dhe plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e detyrave, mban përgjegjësi për futjen e personave të autorizuar në stacion.

Shefi i seksionit të parashikimit të motit është ushtarak aktiv ose civil, i cili varet nga Shefi i Zyres Qendrore dhe ka për detyrë: të organizojë, drejtojë

jtjen e saj.

Parashikimi i motit, nga 24 orë deri në 5 ditë, kryhet nga Zyra Qendrore në Tiranë. Në degët e tij do të kryhet parashikimi me afat deri në 6 orë (now-casting). Parashikimi i motit kryhet mbi bazën e analizës dhe interpretimit të informacionit mbi proceset atmosferike në sipërfaqen e tokës dhe shtresat e sipërme të atmosferës.

Sinoptikanti varet nga shefi i Seksionit të parashikimit të motit. Ai ka për detyrë: të ndjeko në vazhdimësi evolucionin e proceseve atmosferike. Analizon hartat sinoptike tokësore. Analizon hartat aerologjike 850mb, 700mb, 500mb, 300mb, 100mb. Merr nga seksioni i informacionit të dhenat e rrjetit të shërbimit meteorologjik ushtarak. Ben parashikimin e motit dhe përgatit buletin meteorologjik. Jep informacion meteorologjik për të gjitha entet e percaktuara në Ligjin e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak dhe aktet nenligjore në fuqi. Në çdo rast kur konstato mundësinë e shfaqjes së ndonjë dukurie të jashtëzakonshme atmosferike, vë në dijeni shefin e Zyres.

Shefi i vendmatjes meteorologjike në Tiranë varet nga shefi i Zyres Qendrore. Shefi i vendmatjes meteorologjike në degë varet nga shefi i degës. Ai ka për detyrë: të organizojë dhe kontrollojë vrojtimet në përputhje me udhëzuesin e vrojtimit meteorologjik, të kontrollojë gjendjen dhe funksionimin normal të aparaturave meteorologjike, të ndjeko ecurinë e dokumentacionit deri në arshivimin e tyre, mban përgjegjësi për ecurinë e punëve të vendmatjes dhe për çdo problem që vë në dijeni shefin e degës, të organizojë dhe drejtojë aftësimin pro-



e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak. i. Organizon punën për dënimin e informacionit meteorologjik në zyrën qendrore. j. Ndjek dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e detyrave.

Shefi i degës është sinoptikan dhe

dhe përgjegjet për mbarevajtjen e punës në seksionin e parashikimit, të kontrollojë zbatimin e programit të aftësimin profesional të personelit të seksionit që drejton, të verë në dijeni shefin e Zyres Qendrore për çdo problem apo nevojë që lind gjatë punës dhe për mbareva-

fesional të personelit të vendmatjes.

Vrojtimet meteorologjike në vendmatjet e rrjetit të Sherbimit Meteorologjik Ushtarak, kryhen në përputhje me udhëzuesit teknikë të Organizatës Botërore të Meteorologjisë. Vrojtuesi varet nga shefi i vendmatjes meteorologjike dhe ka për detyrë: të bejë vrojtimin dhe regjistrimin e elementeve meteorologjike sipas udhëzuesit të vrojtimit meteorologjik. Për çdo problem që ka të bëjë me mbarevajtjen e punës të verë në dijeni shefin e seksionit të vrojtimit. Të mos lejojë asnjë person të pautorizuar të hyjë në zyren e punës. Përgjegjet për bazën materiale dhe instrumentat meteorologjike në përdorim dhe i dorëzon me përgjegjësi ato.

Në fillim të shërbimit vrojtuesi kontrollon dhe shenon në librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit gjendjen e kontrolluar të stacionit. Në përfundim të shërbimit vrojtuesi dorëzon në gjendje të rregullt vendmatjet meteorologjike dhe zyren e punës. Ruajtja e të dhenave të vrojtuesit Formularët e ndryshëm dhe ditaret për regjistrimin e vrojtimit të sistemoshen mirë dhe ruhen me kujdes në dollap të mbyllur. Pas mbylljes së muajit ditaret sistemoshen në arkive. Informacioni i grumbulluar nga vendmatjet e rrjetit kombëtar meteorologjik dërgohet në Arkivën Kombëtare Meteorologjike pranë Institutit Hidrometeorologjik, në baze të mareveshjes së nënshkruar midis dy paleve. Specialisti i aerologjisë siguron informacion mbi shtresat e sipërme të atmosferës për nevojat të ndryshme të shërbimit meteorologjik. Asiston dhe jep informacionin e nevojshëm për zhvillimin e qitjeve kundërajrore. Shefi i seksionit të informacionit varet nga shefi i Zyres Qendrore. Ai ka për detyrë: të organizojë dhe kontrollojë punën në seksionin e informacionit, të kontrollojë gjendjen dhe funksionimin normal të aparaturave që ka në përdorim, të ndjeko ecurinë e punës për koordinimin e shkëmbimit të të dhenave me të gjithë degët dhe seksionet, të mbledhë të dhenat meteorologjike nga rrjeti i shërbimit meteorologjik ushtarak, t'i përpunojë dhe transmetojë ato në rrjetin ndërkombëtar. Operatori Operatori varet nga shefi i seksionit të informacionit dhe ka për detyrë, të mbledhë të dhenat në orët e caktuara dhe jashtë këtyre orëve në raste emergjencash, të përpunojë informacionin meteorologjik dhe të plotësojë dokumentacionin perkates duke përgatitur atë për arkivim, të japë zyres së parashikimit të motit informacionin e marrë nga rrjeti i shërbimit meteorologjik ushtarak.



## Projekti Tematik "TO BE READY"-bashkëfinancim nga BE

# Shpallet vend i lirë pune, menaxher komunikimi

*Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit me postë ose drejtpërdrejtë deri më datë 24.10.2020, ora 16.00*

**N**ë kuadrin e Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY management- 355", me bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", me vlerë 5 milionë euro, Ministria e Mbrojtjes fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës si vijon:

Menaxher komunikimi për zbatimin rojektit tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY management-355", bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020".

Pozicioni i punës: menaxher komunikimi.

Reparti/Institucioni: Ministrinë e Mbrojtjes. Vendi: Tiranë. Mënyra e aplikimit: me dosje dhe intervistë. Lloji i kontratës së punës: për një kohëzgjatje të përcaktuar. Data e mbylljes së aplikimit: kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit me postë ose drejtpërdrejtë deri më datë 24.10.2020, ora 16.00, në adresën: Ministria e Mbrojtjes, Rr. Dibrës, 1001, Tiranë, Shqipëri, me subjekt: Aplikim për pozicionin Menaxher Komunikimi, i Projektit Tema-



tik "TO BE READY"- "The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY management -355",

INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Ministria e Mbrojtjes, 5 ditë mbas mbylljes së afatit të dorëzimit

të dokumenteve nga kandidatët do të shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes listën e kandidatëve që

plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të pozicionit, si dhe vendin dhe orën e zhvillimit të intervistës. Intervista do të zhvillohet në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes.

Menaxheri i komunikimit është përgjegjës për mbikqyrjen e të gjitha komunikimeve të brendshme dhe të jashtme të projektit, duke siguruar që mesazhi i projektit të jetë i qendrueshëm dhe terheqës. Ai do të punojë për të nxitur imazhin e projektit përmes mesazheve dhe strategjive të qendrueshme, si dhe mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes në drejtim të synimeve të komunikimit. Duhet të bashkëpunojë ngushtesisht me menaxherin e projektit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes dhe partneret e projektit për të siguruar një paraqitje dhe prezantim efikas të ecurisë të projektit. Për më shumë ju lutem shkarkoni filen pdf. Në web të Ministrisë së Mbrojtjes, "Njoftime".

### PROJEKTI TEMATIK "TO BE READY"-BASHKËFINANCIM NGA BE

# Shpallet vend i lirë pune për financier

*Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit me postë ose drejtpërdrejtë deri më datë 24.10.2020, ora 16.00*



**N**ë kuadrin e Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY management-355", me bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali - Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", me vlerë 5 milionë euro, Ministria e Mbrojtjes fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës si vijon: Financier për zbatimin rojektit tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY management-355", bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020".

**Pozicioni i punës: financier projekti**

Reparti/Institucioni: Ministrinë e Mbrojtjes, Vendi: Tiranë. Mënyra e aplikimit: me dosje dhe intervistë. Lloji i kontratës së punës: për një kohëzgjatje të caktuar. Data e mbylljes së aplikimit: kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit me postë ose drejtpërdrejtë deri më datë 24/10/2020, ora 16.00, në adresën: Ministria

e Mbrojtjes, Rr. Dibrës, 1001, Tiranë, Shqipëri, me subjekt: Aplikim për pozicionin Financier Projekti, i Projektit Tematik "TO BE READY"- "The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY manage-

ment- 355", INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Ministria e Mbrojtjes, 5 ditë mbas mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumenteve nga kandidatët do të shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes listën e kandidatëve që

plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të pozicionit, si dhe vendin dhe orën e zhvillimit të intervistës. Intervista do të zhvillohet në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes. Financieri i projektit është përgjegjës për mbajtjen e

kontabilitetit të projektit, paraqitjen e raporteve financiare, raportimin në sistemin eMS dhe menaxhimin e brendshëm të fondeve. Për më shumë ju lutem shkarkoni filen pdf. Në web të Ministrisë së Mbrojtjes, "Njoftime".



# Konflikti në Mesdheun Lindor

## NATO vendos Mekanizmin Ushtarak të de-konfliktit midis Greqisë dhe Turqisë

*Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, viziton Turqinë dhe Greqinë*

Përgatiti: MSC. MIMOZA GOLIKJA

Pas një serie takimesh teknike midis Përfaqësuesve Ushtarakë të Greqisë dhe Turqisë në Selinë e NATO-s në Bruksel, u krijua më 1 tetor 2020, një mekanizëm dypalësh ushtarak i de-konfliktit. Mekanizmi është krijuar për të zvogëluar rrezikun e incidenteve dhe aksidenteve në Mesdheun Lindor. Ai përfshin krijimin e një linje të veçantë midis Greqisë dhe Turqisë, për të lehtësuar de-konfliktin në det ose në ajër. Bisedimet teknike ushtarake mbi konfliktin, të cilat nisën në fillim të shtatorit, u iniciuan nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg pas kontakteve të nivelit të lartë me Greqinë dhe Turqinë. Z. Stoltenberg pas krijimit të mekanizmit ushtarak tha se “Unë mirëpres krijimin e një mekanizmi ushtarak të de-konfliktit, i arritur përmes angazhimit konstruktiv të Greqisë dhe Turqisë, të dy aleatë të NATO-s me vlerë. Ky mekanizëm i sigurisë mund të ndihmojë në krijimin e hapësirës për përpjekjet diplomatike për të adresuar mosmarrëveshjen themelore dhe ne jemi të gatshëm ta zhvillojmë atë më tej. Unë do të qëndroj në kontakt të ngushtë me të dy aleatët.”

De-konfliktimi ushtarak midis aleatëve është një rol që NATO ka luajtur edhe më parë. Në vitet 1990, NATO ndihmoi në krijimin e një mekanizmi të ngjashëm në rajon, i cili ishte efektiv për të ndihmuar në uljen e tensioneve dhe sigurimin e hapësirës për bisedime më të gjera diplomatike.

Dhe menjëherë pas krijimit të mekanizmit dypalësh ushtarak të de-konfliktit burimet e NATO-s nftuan se Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg do të zhvillonte një vizitë në Turqi dhe Greqi për bisedime me zyrtarë të lartë dhe më 5 tetor Stoltenberg udhëtoi në Ankara, ndërsa më 6 tetor, udhëtoi drejt Athinës. Në Ankara Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg, u takua me ministrin e Punëve të Jashtme, Mevlüt Çavuşoğlu dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë. E nërsa në Athinë ai u takua me kryeministrin Kyriakos Mitsotakis, ministrin e Punëve të Jashtme, Nikos Dendias dhe ministrin e Mbrojtjes, Nikos Panagiotopoulos.

Vizita e shefit të NATO-s erdhi pasi takimet në dtën e parë të tetorit, në selinë e NATO-s në Bruksel, Turqia dhe Greqia arritën “mirëkuptim të përbashkët mbi parimet e përgjithshme” për Mesdheun Lindor. Duke filluar nga 10 shtatori delegacionet ushtarake turke dhe greke zhvilluan disa bisedime teknike të drejtuara nga NATO. Bisedimet u planifikuan pas një telefonate midis presidentit turk, Recep Tayyip Erdoğan dhe Stoltenberg në fillim të shtatorit. Ministria turke e Mbrojtjes njoftoi se raundi i gjashtë i bisedimeve u zhvillua të martën.

### Turqia aleate e vlerësuar e NATO-s, kontribute të rëndësishme për sigurinë e përbashkët

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg e filloi vizitën dy-ditore nga Turqia dhe më pas ai shkoi drejt Greqisë (5 dhe 6 tetor 2020). Ndërsa ishte në Ankara, Stoltenberg pati diskutime me Presidentin Rexhep Tajip Erdogan, ministrin e Jashtëm Mevlüt Çavuşoğlu dhe ministrin e Mbrojtjes Hulusi Akar në lidhje me situatën e sigurisë në rajon, mbështetjen e NATO-s për Turqinë dhe krijimin e një mekanizmi ushtarak të de-konfliktit me Greqinë.

Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi kontributet e Turqisë në misionet e NATO-s, përfshirë Afganistanin, Irakun dhe Kosovën dhe mbështetjen e saj për aleatët dhe partnerët e tjerë gjatë pandemisë. Stoltenberg theksoi gjithashtu angazhimin e fortë të NATO-s për sigurinë e Turqisë duke shtuar mbrojtjen e saj ajrore kundër sulmeve raketore nga Siria



dhe duke rritur praninë ajrore dhe detare të Aleancës. Sekretari i Përgjithshëm mirëpriti krijimin e mekanizmit ushtarak të de-konfliktit për të zvogëluar rrezikun e incidenteve dhe aksidenteve në Mesdheun Lindor. Kjo përfshin angazhimin për të përdorur një linjë telefonike të sigurt që është vendosur midis Greqisë dhe Turqisë. Stoltenberg tha se “Mekanizmi u arrit përmes angazhimit konstruktiv të Turqisë dhe Greqisë në Selinë e NATO-s. Unë e mirëpres këtë dhe u bëj nderime të dy aleatëve për përpjekjet e tyre, dhe ne jemi të gatshëm ta zhvillojmë atë më tej.” Ai shtoi se “Mekanizmi i konfliktit mund të ndihmojë në krijimin e hapësirës për përpjekje diplomatike. Është shpresa ime e palëkundur që mosmarrëveshjet themelore tani mund të adresohen thjesht përmes negociatave, në frymën e solidaritetit aleat dhe të së drejtës ndërkombëtare.” Diskutimet adresuan gjithashtu situatën në Libi dhe Siri, dhunën e vazhdueshme në dhe përreth Nago-Karabakut, dhe blerjen nga ana e Turqisë të sistemit S-400.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në konferencën e përbashkët për shtyp me ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu theksoi se “Turqia është një aleate e NATO-s e vlerësuar, duke dhënë kontribute të rëndësishme për sigurinë tonë të përbashkët. Turqia tregoi solidaritet me aleatët dhe partnerët gjatë pandemisë duke ofruar mbështetje thelbësore në luftën tonë të përbashkët kundër COVID-19. Ju jeni një nga kontribuesit më të mëdhenj për misionin tonë trajnuar në Afganistan, i cili po ndihmon në krijimin e kushteve për paqe. Ju jeni gjithashtu pjesë e misioneve tona në Kosovë dhe Irak dhe ju luani një rol të madh në luftën kundër terrorizmit. Kështu që Turqia është një aleate e vlerësuar, duke kontribuar në NATO në shumë mënyra të ndryshme. NATO gjithashtu kontribuon në sigurinë e Turqisë, duke shtuar mbrojtjen tuaj ajrore kundër sulmeve raketore nga Siria dhe duke rritur praninë tonë ajrore dhe detare. Polonia ka njoftuar sic e përmendët ju,

dhe duke vendosur një avion patrullues detar dhe aleatë të tjerë po planifikojnë të rrisin mbështetjen e tyre për Turqinë. Pra, NATO mbetet fuqimisht e përkushtuar në sigurinë e Turqisë.

Sot diskutuam për tensionet në Mesdheun Lindor. Tani kemi krijuar një mekanizëm ushtarak të de-konfliktit për të zvogëluar rrezikun e incidenteve dhe aksidenteve në rajon. Kjo përfshin një angazhim për të përdorur një linjë të sigurt të nxehtë që është vendosur midis Greqisë dhe Turqisë, e disponueshme 24/7. Mekanizmi u arrit përmes angazhimit konstruktiv të Turqisë dhe Greqisë në Selinë e NATO-s. Unë e mirëpres këtë dhe u bëj nderime të dy aleatëve për përpjekjet e tyre dhe ne jemi të gatshëm ta zhvillojmë më tej. Mekanizmi i konfliktit mund të ndihmojë në krijimin e hapësirës për përpjekje diplomatike dhe është shpresa ime e palëkundur që mosmarrëveshjet themelore tani mund të adresohen thjesht përmes negociatave në frymën e solidaritetit aleat dhe të së drejtës ndërkombëtare.

Ne përballlemi me një numër çështjesh të vështira. Kjo e bën edhe më të rëndësishme për mua t'i drejtohem drejtpërdrejt me udhëheqjen turke. Ne jemi të brenjosur për pasojat e blerjes së Turqisë të Sistemit S-400. Sistemi mund të paraqesë rrezik për avionët aleatë dhe mund të çojë në sanksione të SHBA-së. Ky është një vendim kombëtar për Turqinë për t'i marrë, por S-400 nuk mund të integrohet në sistemin e mbrojtjes ajrore dhe raketore të NATO-s dhe unë e nxis Turqinë të punojë me aleatët e tjerë për të gjetur zgjidhje alternative. E diskutuam këtë gjatë takimit tonë sot. Ne gjithashtu adresuam situatën e ndërlikuar në Libi dhe Siri dhe dhunën e vazhdueshme në dhe përreth Karabakut. Ne jemi thellësisht të shqetësuar nga përshkallëzimi i luftimeve. Të gjitha palët duhet të pushojnë menjëherë luftimet dhe të gjejnë një rrugë përpara drejt një zgjidhje paqësore. Unë pres që Turqia të përdorë ndikimin e saj të konsiderueshëm për të qetësuar tensionet. Ne kemi pasur diskutime të rëndësishme për disa nga

sfidat më të ngutshme të ditës dhe mezi pres t'i diskutoj ato me Presidentin Erdogan gjithashtu sot më vonë. NATO ofron platformën për shkëmbime të tilla midis aleatëve dhe miqve”, tha në takimin e përbashkët të shtypit Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg.

### Mekanizmi ushtarak i de-konfliktit, Stoltenberg përgëzon në Athinë angazhimin e Greqisë dhe Turqisë

Pas takimit me zyrtarë të lartë në Ankara, të nesërmen më 6 tetor, Sekretari i Përgjithshëm ishte në Athinë për bisedime me Presidenten Katerina Sakellariopoulou, Kryeministrin Kyriakos Mitsotakis, ministrin e Jashtëm Nikos Dendias dhe ministrin e Mbrojtjes Nikos Panagiotopoulos. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Greqinë për kontributin e saj të rëndësishëm në NATO në takimet e tij dhe adresoi situatën e sigurisë në rajon. Ai vlerësoi rolin e Greqisë si një aleat i vlerësuar dhe kontributet e saj në misionet e NATO-s, nga Afganistani në Kosovë. Stoltenberg theksoi se NATO është një platformë e rëndësishme për dialog, ku aleatët nga Evropa dhe Amerika e Veriut bashkohen çdo ditë për të diskutuar çështje që ndikojnë në sigurinë tonë. Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi angazhimin konstruktiv të Greqisë dhe Turqisë në Selinë e NATO-s, e cila mundësoi krijimin e një mekanizmi dypalësh ushtarak të de-konfliktit për të zvogëluar rrezikun e incidenteve dhe aksidenteve në Mesdheun Lindor. Ai theksoi se mekanizmi i de-konfliktit mund të ndihmojë në krijimin e hapësirës për përpjekjet diplomatike për të adresuar çështjet themelore. Stoltenberg shprehu bindjen e tij me shpresën që mosmarrëveshja themelore midis dy aleatëve tani mund të adresohet thjesht përmes negociatave dhe në frymën e solidaritetit aleat dhe të së drejtës ndërkombëtare. Për disa vite, Greqia ka qenë në vijën e parë të krizës së refugjatëve dhe migrantëve.

Stoltenberg siguroi Greqinë për solidaritetin e NATO-s dhe falënderoi Athinën për përpjekjet e saj për të prerë linjat e kontrabandës njerëzore. Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi gjithashtu Greqinë për investimin e 2% të PBB-së në mbrojtje dhe angazhimin e saj në sigurinë kolektive.

Në fjalën e tij në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin grek Kyriakos Mitsotakis Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se “Greqia është me të vërtetë një aleate e vlerësuar. Ju jeni të përkushtuar për sigurinë tonë të përbashkët dhe ju kontribuoni në NATO në shumë mënyra të ndryshme, me kontribute në misionet e NATO-s, nga Afganistani në Kosovë. Avionët tuaj ndihmojnë në sigurinë e qiellit mbi Malin e Zi dhe forcat tuaja detare janë një pjesë e rëndësishme e qëndrimit detar të NATO-s, kështu që ne jemi mirënjohës për të gjitha kontributet tuaja. Atëherë sigurisht që ne gjithashtu e mirëpresim faktin që Greqia harxhon më shumë se 2 përqind investime të PBB-së në mbrojtje dhe ne gjithashtu mirëpresim njoftimin se si do të modernizoni më tej forcat tuaja të armatosura. Kjo do të forcojë NATO-n. Të gjitha këto kontribute e mbajnë Greqinë të fortë dhe ato e mbajnë të fortë NATO-n.

Ne diskutuam situatën e sigurisë në rajonin e gjerë dhe përgjigjen e NATO-s. Për disa vite, Greqia ka qenë në vijën e parë të krizës së refugjatëve dhe migrantëve, NATO qëndron me ju në solidaritet. Misioni i NATO-s në Detin Egje mbështet autoritetet greke dhe turke dhe agjencinë kufitare të BE-së Frontex, në përpjekjet e tyre për të prerë linjat e kontrabandës njerëzore. Unë falënderoj Greqinë për kontributin tuaj në këtë vendosje. Ajo gjithashtu tregon se si NATO ndihmon për të forcuar bashkëpunimin midis aleatëve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, duke u marrë me një çështje që është me shumë rëndësi për të gjithë ne. Ne diskutuam gjithashtu tensionet e fundit në Mesdheun Lindor. Përmes angazhimit konstruktiv të Greqisë dhe Turqisë në Selinë e NATO-s, ne tani kemi krijuar një mekanizëm dypalësh ushtarak të de-konfliktit. Kjo përfshin një angazhim për të përdorur një linjë të sigurt telefonike midis Greqisë dhe Turqisë, e disponueshme 24 orë në ditë, për të lehtësuar de-konfliktin në det dhe në ajër. Unë e mirëpres këtë dhe i nderoj të dy aleatët për përpjekjet tuaja. Dhe ne jemi të gatshëm ta zhvillojmë më tej. Mekanizmi i konfliktit mund të ndihmojë në krijimin e hapësirës për përpjekje diplomatike, është shpresa ime e palëkundur që mosmarrëveshjet themelore midis dy aleatëve tani mund të adresohen thjesht përmes negociatave, në frymën e solidaritetit aleat dhe të së drejtës ndërkombëtare.

Ne gjithashtu diskutuam shqetësimet në lidhje me praninë ushtarake në rritje të Rusisë në rajonin e Mesdheut. Kjo ka implikime për sigurinë tonë, prandaj duhet ta trajtojmë së bashku. Aleanca jonë është një platformë e rëndësishme për dialog, ku Aleatët nga Evropa dhe Amerika e Veriut bashkohen çdo ditë për të diskutuar çështje që kanë rëndësi për sigurinë tonë, pavarësisht se sa të vështira mund të jenë disa nga këto çështje, sepse ne e dimë që jemi më të fortë duke iu drejtuar së bashku. Aleanca jonë është e fortë sepse ne qëndrojmë së bashku.”



## FORUMI ATLANTIK "TRANSATLANTIZMI 2020"

# Geoana: NATO duhet të vazhdojë të përshtatet për të ardhmen

"NATO 2030", që synon të shqyrtojë se si Aleanca mund të përshtatet për të përballuar sfidat e së ardhmes

Duke ju drejtuar një auditori profesionistësh të rinj në konferencën virtuale të Forumit Atlantik "Transatlantizmi 2020" më 2 tetor 2020, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană tha se në mënyrë që të merret me një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks, Aleanca duhet të vazhdojë t'i përshtatet sfidat e së ardhmes.

"Aleanca jonë është më e suksesshme në histori për shkak të aftësisë sonë për t'u përshtatur," tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm. Ai vuri në dukje se krahasuar me të kaluarën kur NATO u përball me një kërcënim të vetëm, Bashkimin Sovjetik, Aleanca tani përballlet me një gamë shumë më të gjerë sfidash – nga kërcënimet konvencionale të terrorizmit, sulmet kibernetike, fushatat dezinformuese dhe ndryshimi i klimës. Ai më tej vuri në dukje "modelin shqetësues të sjelljes" të Rusisë si shqetësim për NATO-n dhe theksoi se Aleanca duhet të kuptojë plotësisht se si "rritja e Kinës ndikon në sigurinë tonë".

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi se paqja dhe lidhja transatlantike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut nuk duhet të merren si të mirëqena. "Vetëm sepse nuk kemi pasur një luftë të madhe në Evropë për 75 vjet, nuk do të thotë që paqja është gjendja natyrore. Historikisht, ky është një devijim", tha ai. "Paqja kërkon punë të vështirë. Paqja jonë bazohet në vlerat tona të përbashkëta dhe në



lidhjen transatlantike midis kombeve të Evropës dhe Amerikës së Veriut". Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Geoană vuri në dukje se Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg ka filluar një proces reflektimi "NATO

2030", që synon të shqyrtojë se si Aleanca mund të përshtatet për të përballuar sfidat e së ardhmes. "Përshtatja do ta bëjë aleancën tonë të fortë transatlantike edhe më të fortë", - tha ai.

Agjencia NCI shpall kualifikuesit e Sfidës së Inovacionit të Mbrojtjes 2020

## Tetë kualifikuesit më të mirë të Sfidës kalojnë në fazën tjetër

Agjencia e Komunikimit dhe Informacionit e NATO-s (NCI) njoftoi (më 30 shtator) tetë kualifikuesit më të mirë të Sfidës së Inovacionit të Mbrojtjes të Agjencisë NCI 2020.

Paneli vlerësues përzgjodhi tetë propozime për fazën tjetër të Sfidës së Inovacionit. Sfida synon të përshpejtojë idetë, teknologjitë dhe zgjidhjet moderne transformuese, nga fillimi, bizneset e vogla dhe akademika në mbështetje të NATO-s.

Këtë vit, ai përqendrohet në përmirësimin e përpunimit të shpërndarjes së të dhënave të radarëve në mënyrë që operacionet ajrore të NATO-s të mund të shfrytëzojnë teknologjitë më të fundit në dispozicion në sektorin e mbrojtjes dhe më gjerë. Parashtrësit u vlerësuan kundër kritereve, duke përfshirë inovacionin, realizueshmërinë e zbatimit dhe efektivitetin e kostos. Sfida është në vitin e pestë. Kualifikuesit kryesorë janë nga Kanada, Republika Çeke, Gjermania, Polonia dhe Turqia. Ata do të ftohen të marrin pjesë në një sesion lartësie në ngjarjen virtuale NITEC Connect të NATO-s në fillim të nëntorit. "Ne ishim të impresionuar nga kalibri i paraqitjeve të këtij viti. Ne shpresojmë të mësojmë më shumë rreth propozimeve në NITEC Connect këtë vit dhe të zbulojmë kompanitë më të kualifikuara", tha Dr Peter Lenk, Shefi i Strategjisë së Shërbimit dhe Inovacionit në Agjencinë NCI. Juria e Sfidës së Inovacionit përbëhet nga ekspertë të lëndës nga NATO dhe AFWERX, një organizatë e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara e përqendruar në inovacione. Ata do të vlerësojnë konkurset e drejtpërdrejta në nëntor dhe do të shpallin fituesit kryesorë, të cilët më pas mund të ftohen të bëjnë oferta për një kontratë në këtë fushë.

### SHEFI I AJRIT MARSHALL SIR STUART PEACH

## Lituanian do shpenzojë 2% të PBB-së së saj në mbrojtje

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s vlerëson mbështetjen e fortë të Lituanisë për NATO-n

Shefi i Ajrit Marshall Sir Stuart Peach, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, vizitoi Vilnius, Lituanë. Ndërsa ishte në Lituanë, (24-26 shtator 2020), Kryetari u takua me gjenerallejtnant Valdemaras Rupsys, shefi i Mbrojtjes së Forcave të Armatosura të Lituanisë, zhvilloi diskutime me përfaqësues të lartë ushtarakë të Lituanisë, vizitoi Parlamentin Lituanëz dhe u takua me Shkëlqesinë e Tij, Z. Viktoras Pranckietis, Kryetari i Parlamentit. Kryetari gjithashtu vizitoi Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Sigurinë e Energjisë përpara se të merrte pjesë në një konferencë mbi projektet e saj më të fundit. Temat e diskutimit gjatë vizitës u përqëndruan në Sigurinë dhe Mbrojtjen e zonës Euro-Atlantike, ndarjen e drejtë të barrës dhe rritjen e rezistencës së NATO-s dhe vendit.

Në Ministrinë e Mbrojtjes të Lituanisë, Shefi i Ajrit Marshal Peach u mirëprit nga priftja e Gardës të Nderit para takimit me gjenerallejtnant Rupsys. Kryetari përgëzoi kontributet e Lituanisë në operacionet dhe misionet e NATO-s, ofrimin e saj të aftësive kombëtare kibernetike për të ndihmuar në luftimin e sfidave hibride, si dhe priftjen e Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Sigurinë e Energjisë. Në diskutimet me zyrtarë të lartë ushtarakë në Ministrinë e Mbrojtjes, Kryetari i NATO-s deklaroi se sa i impresionuar ishte nga profesionalizmi dhe përkushtimi i Forcave të Armatosura Lituanëze, në Selinë e NATO-s dhe mbi Operacionet.

NATO nuk ka forcat e veta; janë aleatët që kon-

tribuojnë me trupa dhe aftësi në operacione dhe misione, të cilat përbëjnë një forcë të NATO-s. Shefi i Ajrit Marshall theksoi, "Që nga anëtarësimi në Aleancë, Lituanian ka qenë një aleat i vendosur, duke kontribuar me forcat e saj sa herë që të jetë e mundur. Sot ajo pret një grup beteje të përparuar të pranisë së përparuar, një njësi integrimi të forcës së NATO-s, si dhe lejon Aleancën të bazojë misionin e saj të Policimit Ajror nga Baza Ajrore Siauliai. Ajo ka trupa në Afganistan dhe Kosovë, si dhe anije në Forcat tona të Përhershme Detare. Këto janë demonstrime të qarta se NATO mund të mbështetet në Lituanian".

Në takim me Shkëlqesinë e Tij, Z. Viktoras Pranckietis, Kryetari i Parlamentit, Shefi i Ajrit Marshal Peach, e falënderoi atë për mbështetjen e vazhdueshme të Lituanisë për Aleancën dhe mënyrën se si ajo udhëheq me shembull në shpenzimet e mbrojtjes. Lituanian po investon në pajisje të mëdha dhe është zotuar të shpenzojë 2% të PBB-së së saj në mbrojtje. Lituanian është gjithashtu pjesë e grupit të aleatëve dhe partnerëve që zotërojnë aftësinë strategjike të ngritjes ajrore së ajrit të menaxhuar nga NATO. Airlift Strategjik ka

luajtur një rol të rëndësishëm gjatë pandemisë të koronavirusit duke mundësuar transportin e pajisjeve mjekësore tek aleatët dhe partnerët. Gjatë vizitës së tij në Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Sigurinë e Energjisë, Shefi i Ajrit Marshal Peach u informua për rëndësinë e Sigurisë së Energjisë dhe qëndrueshmërisë kombëtare. Ai theksoi se një furnizim i qëndrueshëm dhe i besueshëm i energjisë, me rrugë të ndryshme dhe furnizues, rrit rezistencën e Aleancës kundër presionit politik dhe ekonomik. Prandaj, NATO po zgjeron lidhjet e saj me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë dhe Bashkimin Evropian për çështjet e energjisë. Kryetari përcaktoi se "Aleanca po rrit mbrojtjen e infrastrukturës sonë të energjisë, duke siguruar avantazhin tonë teknologjik dhe duke rritur përgjigjen tonë ndaj kërcënimeve hibride. Ne duhet të vazhdojmë të forcojmë mbrojtjen tonë kibernetike dhe sigurinë e energjisë ndërsa mësojmë nga pandemia dhe përgatitemi për krizën e ardhshme. Një furnizim i qëndrueshëm dhe i besueshëm i energjisë, me rrugë dhe furnizues të ndryshëm, rrit qëndrueshmërinë tonë ndaj presionit politik dhe ekonomik".





Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Anton Quni, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit, qeverisë dhe Forcave të Armatosura të Turqisë në ndërtimin dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit tonë, vet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës.



## Ministri i Mbrojtjes Anton Quni vizitë zyrtare në Turqi

# Quni-Akar: Bashkëpunim në fushën e industrisë së mbrojtjes

*Në takim u diskutuan bashkëpunimi bilateral në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe bashkëpunimi në fushën e industrisë së mbrojtjes*

Në kuadër të vizitës zyrtare katër ditore në Republikën e Turqisë, në selinë e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, me protokollin më të lartë shtetëror dhe ceremoni të lartë ushtarake, Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, u prit me 29 shtator 2020 në takim nga homologu i tij dhe nikoqiri, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Hulusi Akar.

Dy ministrat zhvilluan takimin kokë më kokë, për të vazhduar pastaj kryesimin e takimit ndërmjet dy delegacioneve. Gjatë këtij takimi, ministri Akar theksoi miqësinë ndërmjet Turqisë dhe Kosovës në përgjithësi dhe partneritetin e fuqishëm ndërmjet dy ministrive dhe forcave në veçanti. Ai theksoi, nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të mira ndërmjet dy vendeve, ministrive dhe forcave si dhe rëndësinë e bashkëpunimit në të mirën e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë. Në takim u diskutuan bashkëpunimi bilateral në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe bashkëpunimi në fushën e industrisë së mbrojtjes.

Në fjalën e tij, Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Anton Quni, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit, qeverisë dhe Forcave të Armatosura të Turqisë në ndërtimin dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit tonë, vet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës. Ndër të tjera, ministri Quni, ritheksoi se partneriteti me Republikën e Turqisë si vend shumë i rëndësishëm i NATO-s, Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare dhe Forcat e Armatosura të Turqisë do të vazhdojë



të jetë i fuqishëm në perspektivën tonë zhvillimore për të arritur aftësitë, kapacitetet dhe standardet më të larta operacionale për ofrimin e shërbimit tonë ndaj paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

Gjatë takimit, me ministrin Akar dhe delegacionin e tij, ministri Quni shoqërohej nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Ankara, Ilir Dugolli, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, shefi i Kabinetit të Ministrit, Jashar Ramadani, atasheu Ushtarak në Ankara, kolonel Bekim Osmani dhe drejtori i departamentit për Bashkëpunim Ushtarak dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha. Takimi u realizua, në kuadër të vizitës zyrtare katër ditore të ministrit Quni dhe delegacionit të tij me ftesë të homologut të tij, ministrit Akar dhe do të vazhdojë me aktivitete tjera me strukturat udhëheqëse të ministrisë, forcave të armatosura dhe industrisë së mbrojtjes.

## Ministri i Mbrojtjes Quni viziton Akademinë Ushtarake të Turqisë

Në vazhdim të aktivitetëve në kuadër të vizitës zyrtare katërditore në Republikën e Turqisë me ftesë të homologut të tij, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka realizuar vizitën në Akademinë Ushtarake Turke ku është pritur nga dekan i saj, Prof. Dr. Gultekin Yıldız dhe komandanti i Regjimentit Studentor të Akademisë, gjeneral brigade Gultekin Yaralı. Gjatë takimit, ministrin Quni, nikoqirët e njoftuan me strukturën organizative, sistemin arsimor, misionin, kapacitet akademik, qëllimin dhe detyrat kryesore të akademisë.

Gjithashtu, ata e njoftuan edhe me të arriturat e kadetëve të FSK-së që studiojnë aktualisht në këtë akademi. Nga ana e tij, ministri Quni, nikoqirët i përgëzoi për të arriturat e akademisë ush-

tarak turke duke shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për përkushtimin e tyre edhe në aftësimin sa më cilësor profesional e akademik të kadetëve tanë të cilët studiojnë aktualisht në këtë akademi. Pas takimit me lidhshmëri e akademisë, ministri Quni realizoi takimin me kadetët e FSK-së që studiojnë në këtë akademi. Nga ta, ai u njoftua me rezultatet e tyre, kushtet e studimeve, sfidat si dhe preokupimet e tyre. Me këtë rast, ministri Quni përgëzoi kadetët tanë për sukseset e arritura dhe vendosmërinë e përkushtimit të tyre për të arritur rezultate sa më të mira. Ai u rikujtoi se përveç privilegjit si kadetë-student, keni edhe përgjegjësinë e ambasadorëve të shtetit dhe kombit si dhe jeni përfaqësuesit e vlerave e identitetit të ushtarakut të

denjë të Kosovës, prandaj i inkurajoi të vazhdojnë të kultivojnë e ngritin sa më lart këto vlera në ambientin studimor shumëkombësh të akademisë përkatëse.


Akademia Ushtarake Turke është akademi ushtarake katër-vjeçare dhe pjesë e Universitetit Kombëtar të Mbrojtjes së Republikës së Turqisë. Misioni i saj është zhvillimi psiko-fizik dhe akademik-profesional i kadetëve të ushtrisë turke dhe mbi 20 shteteve aleate dhe miqësore të saj nga regjione dhe kontinente të ndryshme të Botës. Në kuadër të marrëveshjes dhe bashkëpunimit bilateral të ministrive dhe forcave respektive, që nga viti 2011, krahas kadetëve tjerë, në këtë akademi studiojnë edhe kadetët e FSK-së.

## Interes për industrinë ushtarake turke

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, gjatë qëndrimit të tij zyrtar në Republikën e Turqisë vizitoi edhe kompanitë turke të industrisë së mbrojtjes në Ankara dhe Stamboll. Ai me delegacionin e tij, vizituan Industrinë e Hapësirës Ajrore Turke (TAI) dhe kompaninë Baykar e cila zhvillon teknologjitë më të përparuara transformuese për fushën e aviacionit. Ata u njoftuan nga afër edhe me avionët, pajisjet dhe sistemet që dizajnnon kompania Baykar në bashkëpunim me kompaninë Roketsan si kompania kryesore e industrisë turke në teknologjinë e raketave. Gjithashtu, ministri Quni me delegacionin e tij vizitoi edhe kompaninë Nurol, ndër prodhuesit kryesor të automjeteve motorike tokësore dhe kompaninë Aselsan si prodhuese kryesore e sistemeve të komunikimit, radarëve, luftës elektronike, mbrojtjes ajrore dhe të shënjestrimit. Edhe në këto kompani u njoftuan me automjetet, pajisjet dhe sistemet funksionale dhe ato në dizajnim e sipër. Këto vizita shënuan edhe përfundimin e vizitës shumë të suksesshme zyrtare të ministrit Quni e cila u realizua me ftesë zyrtare të homologut të tij turk, ministrit Akar, në funksion të thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.







“Vendi jep një kontribut të rëndësishëm duke marrë pjesë në misionet ndërkombëtare dhe deri më tani janë dërguar mbi 4,000 trupa. Unë jam e kënaqur që oficerët tanë kanë përfunduar me sukses misionin. Kjo është një përvojë e madhe për oficerët tanë. Këto misione profilizojnë profesionistët tanë më të mirë,” - tha ministrja Shekerinska.



NË MISIONET NDËRKOMBËTARE JANË DERGUAR MBI 4,000 TRUPA


# Zaev: Pjesëtarët e armatës ushtarake janë një krenari për vendin

*Maqedonia e Veriut filloi kontributin e saj në misionin “Mbështetja e Vendosur” në Afganistan 6 vjet më parë me 13 rotacione gjashtë-mujore*

